

A. M. P.

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

SHTATOR 2022

Agjencia ka marrë masa dhe ka siguruar kushtet për të zbardhur dhe administruar ankesat e ardhura në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga publiku, si dhe ankesa e shqetësime të adresuara nëpërmjet institucioneve të tjera të administratës publike apo nga media vizive dhe ajo e shkruar.

Të gjitha ankesat e reja regjistrohen në Sistemin e Menaxhimit të Çështjes, për t'u ndjekur në vijim, në kohë reale, në përputhje me ligjin dhe procedurat standarde të punës për trajtimin e ankesave.

MËNYRAT E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT

Për ankesa ndaj strukturave objekt i veprimtarisë




ankesa@amp.gov.al



0800 90 90

Për denoncime në kuadër të Vetingut në Polici



denonco@amp.gov.al



Rr. "Asim Vokshi", Nr. 19/1, Tiranë

Për t'u paraqitur në zyrat tona



Zyra e Pritjes së Qytetarëve në
Drejtorinë e Përgjithshme

Zyrat e Drejtorive Rajonale pranë
DVP-ve në Qarqe

Për t'u informuar rreth AMP, na ndiqni



www.amp.gov.al



VEPRIME HETIMORE

Referimet e bëra në Prokurori

15 referime në Prokurori për **20** punonjës të Policisë së Shtetit dhe **5** shtetas për kryerjen e veprave të ndryshme penale.

Në kuadër të procedimeve penale të realizuara, të arrestuar/ndaluar dhe me masa sigurie nga Gjykata janë **5** shtetas, nga të cilët **3** punonjës policie dhe **2** shtetas, si më poshtë vijon;

Arrestuar/ndaluar në flagrancë

1 punonjës policie i arrestuar në flagrancë.

Ekzekutimet e vendimeve të masave të sigurisë të dhëna nga Prokuroria/Gjykata

Vendosur masa e sigurimit personal “Pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”

2 punonjës policie dhe **2** shtetas

INSPEKTIVE

Agjencia kryen inspektive pranë të gjitha subjekteve ndaj të cilave ushtron mbikëqyrjen në bazë të një plani të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, si dhe në bazë të veprimtarisë, apo një ngjarje të caktuar.

Gjatë muajit janë kryer **9** inspektive të paplanifikuara të strukturave që janë objekt i veprimtarisë së AMP, të iniciuara nga ankesat e qytetarëve apo ngjarjet e denoncuara nga media të ndryshme në vend.

Në përfundim të inspektimeve, Komisioni Disiplinor i Agjencisë vendosi fillimin e hetimit disiplinor për shkelje të rëndë, si edhe pezullimin e **4** punonjësve.

HETIME ADMINISTRATIVE TË ANKESAVE

Zyra e pritjes së qytetarëve dhe komunikimi me publikun



387 Telefonata

në linjën e gjelbër **08009090**, nga të cilat;

167 telefonata brenda objektit të veprimtarisë së AMP (Në ndjekje nga strukturat përgjegjëse të Agjencisë)

80 telefonata jashtë objektit të veprimtarisë së AMP (Adresuar strukturave të administratës publike për ndjekje)

140 telefonata i është dhënë informacioni sipas rastit (Qytetarët janë orientuar drejt strukturës kompetente të administratës publike që trajton ankesat e tyre)



Ankesa të trajtuara

Ky grup nënkupton përfundimin e trajtimit të ankesës dhe kthimin e përgjigjes për qytetarin.

101 ankesa



Ankesa të administruara

Administrimi nënkupton regjistrimin e çdo ankese, pavarësisht nëse duhet të ndiqet nga Agjencia apo një institucion tjetër i Administratës Publike. Ankesat administrohen në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave, ku secila merr një numër unik.

74 ankesa